Shkëlqesia Juaj Z. President,

Zoti Ministër i Drejtësisë,

Zonja Drejtoreshë e Shkollës së Magjistraturës,

Zotërinj Ambasadorë,

Zonja dhe Zotërinj magjistratë të lartë shqiptarë,

Zonja dhe Zotërinj pjesëmarrës në konferencën rajonale mbi drejtësinë,

Zonja dhe Zotërinj laureatë të Shkollës së Magjistraturës,

Jam veçanërisht e nderuar të marr pjesë sot në ceremoninë e diplomimit të magjistratëve të rinj, të cilët përfunduan formimin e tyre në Shkollën shqipare të Magjistraturës.

Kjo ceremoni është shumë e veçantë këtë vit : ajo përkon në fakt, siç ju e dini, me 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë dhe me 15-vjetorin e themelimit të Shkollës shqiptare të Magjistraturës.

Që prej themelimit të saj, Shkolla, siç e theksoi Znj. Semini, ka bërë një rrugë të gjatë.

Dhurata më e bukur që Shkolla e Magjistraturës mund t'i bëjë këtë vit vendit tuaj në këtë përvjetor të dyfishtë është t'i dhurojë një brez të ri me gjyqëtarë dhe prokurorë të diplomuar, të punësuar dhe të formuar sipas kritereve ndërkombëtare të njohura, të cilat mundësojnë një sistem gjyqësor të pavarur, të paanshëm, profesional dhe efikas.

Është një privilegj për Ambasadën e Francës dhe delegacionin francez që mori pjesë në konferencën rajonale mbi drejtësinë, të ndajë këtë moment me ju. Dhe gjej rastin t'ju falënderoj edhe një herë, Zoti President i Republikës, që pranuat t'i jepni mbështetjen e tuaj kësaj konference.

Është një privilegj veçanërisht për Zonjën Berhault, e cila më kërkoi t'ju them se sa e emocionuar është dhe t'ju dërgoj përshëndetjet dhe urimet më të mira nga Shkolla kombëtare e Magjistraturës së Bordosë, të cilën ajo përfaqëson.

Shkolla Shqiptare e Magjistraturës është një element thelbësor për zhvillimin e drejtësisë shqiptare dhe reformën e saj. Unë e di, Zoti President i Republikës, Zoti Ministër, se ju mbështesni përparimin e drejtësisë shqiptare dhe se jeni të

vendosur për të punuar në këtë drejtim. Ju mund të mbështeteni në ndihmën e Francës dhe në ndihesën time personale.

Zonja dhe Zotërinj laureatë të Shkollës, ju filloni sot një fazë të re të jetës tuaj. Ju keni zgjedhur një profesion me kërkesa të larta, i cili është një angazhim moral dhe etik në shërbim të vendit tuaj dhe të bashkëkombësve tuaj.

Ju jeni gjenerata e re e magjistratëve. Ju do të zbatoni reformat e ndërmarra nga kolegët tuaj më të vjetër në mënyrë që drejtësia për vendin tuaj të jetë efektive, e pavarur, transparente dhe e përgjegjshme. Vendi juaj ka besim te ju.

Ju keni një detyrë të rëndë përpara, por ajo është gjithashtu një sfidë e bukur profesionale dhe personale.

Ju përgëzoj për zgjedhjen tuaj me kaq kërkesa të larta dhe ju bëj urimet e mia më të mira për sukses.